

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, bazuar në nenin 16 të Ligjit nr.03/L-079, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr.2006/50, për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën Bujqësore dhe atë Komerciale, kolegji në përbërje nga gjyqtarët, Beshir Islami kryetar i kolegjit, Ragip Namani dhe Jelena Krivokapić anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike **të palës ankuese;**

S. N., me vendbanim në ..., Kraljevo, R. e Serbisë

Duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/232/2014, të datës 13 Mars 2014, (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA49511), pas shqyrtimit të mbajtur me datë, 09 tetor 2019, merr;

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e paraqitur nga **S. N.**, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/232/2014, të datës 13 Mars 2014, për sa i përket lëndës së regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronave me numër KPA49511.
2. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/232/2014, i datës 13 Mars 2014, për sa i përket lëndës së regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronave me numër KPA49511.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Me datë 12 Shtator 2007, S. N., (tutje pala ankuese), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (tutje AKP), në cilësinë e bartësit të drejtës pronësore, (BDP), me të cilën kërkon vërtetimin e të drejtës pronësore si pronarë dhe ri-posedimin e lokalit afarist në sipërfaqe prej 38,19m², i cili gjendet në ngastrën kadastrale, nr. ..., në ..., rr. ..., (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar).
2. Në kërkesë thekson se pas blerjes, lokali ka qen i kompletuar për punë si shitore e mallrave të përziera. Si datë të humbjes së posedimit e shënon datën 20.06.1999, si rezultat i rrethanave të viteve 1998/99, në Kosovë. Po ashtu thekson se lokali është i uzurpuar nga NN persona, andaj kërkon kompensimin për shfrytëzimin pa lejen e tij si dhe kthimin e të njëjtit në posedim.
3. Në mbështetje të kërkesës së tij në AKP, ka dorëzuar dokumentet vijuese;
 - Kontratën për shitblerjen e lokalit afariste të lidhur me datë 13.12.1990, (nr. i protok. ..., dt.14.12.1990), në mes tij si blerës, dhe shitësit Ndërmarrjes së re ndërtimore “...” nga ..., me seli në rr. Brigada e Rinisë, pa nr. në ..., të cilën e përfaqëson drejtori P. Č., lidhur me shitblerjen e lokalit-hapësirës së ndërtuar për tregti, e cila gjendet në ... Komuna ... në sipërfaqe, neto prej 33,25m² dhe hapësirë të përbashkët 04,94m², në

sipërfaqe përgjithshme prej 38,19m², me çmim blerës në shumë të përgjithshme prej 572.850,00 dinarë.

- Kopjen e Planit për ngastrën kad. ..., me kulturë ndërtesë-shkollë dhe kullosë ,në vendin e quajtur Novi Obiliq ,në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.18.62ha., Fleta poseduese, Nr. ... (...), e cila evidencohet në emër të Shkollës Fillore “...”-...
 - Procesverbalin nr. ..., dt.07.04.1994, të hartuar nga Inspeksioni i KK ..., lidhur me kryerjen e shikimit inspektues të lokalit afarist, në të cilin shënohet gjendja, e lokalit si jo i kompletuar.
 - Vërtetimin lëshuar nga NDGP “R. S.”, që pala ankuese për lokalin afarist lëndor e ka paguar shumën e përgjithshme prej 572.850,00 dinarë.
 - Fatura për pagesën e energjisë elektrike, shërbimeve të telefonisë, për lokalin afarist të viteve 1994-97.
4. Me datë 28 janar 2008, nga AKP-ja, është bërë identifikimi i pronës së kërkuar i cili gjendej në ngastrën kad. ..., Zona Kadastrale Obiliq. Në momentin e vizitës prona rezultoi të jetë shitore-lokal, i dëmtuar i pa uzurpuar nga askush. Asnjë palë e interesuar nuk ka paraqitur kërkesë apo interes për pronën lëndore na afatin ligjor prej 30 ditë në AKP, prandaj kërkesa e palës ankuese është konsideruar jo kontestuese.
5. Sipas raportit të verifikimit të AKP-së, të dt. 21.02.2008, *ex officio*, është gjetur dhe verifikuar Kopja e Planit nr...., sipas certifikatës pronësore nr. Ul ..., dt. 12.02.2008, dhe ngastra kadastrale, nr. ..., në sipërfaqe prej 1862,m², me kulturë kullosë dhe shkollë, evidentohet si pasuri shoqërore- shfrytëzues shkolla fillore, ..., në ...
6. Sipas raportit të konsoliduar-përfundimtar të verifikimit të AKP-së , të datës 27.01.2014, kontrata e shitblerjes së lokalit afarist të kërkuar me nr. ..., e dt. 14.12.1990, e paraqitur nga pala ankuese, nuk është gjetur në arshivat e përkatëse të shitësit, Ndërmarrjes Ndërtimore “R. S.”, dhe as në regjistrat e institucionet kompetente në Kosovë, prandaj verifikimi i këtij dokumenti kishte rezultuar negativ, si jo i vërtetë.
7. Me datë 13 Mars 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK), me vendimin e vet KPCC/D/C/232/2014, ka vendosur që kërkesa e palës kërkuese S. N. të refuzohet. Në paragrafët 44, 45, 50, të arsyetimit të vendimit grupor, i cili zbatohet në veçanti për kërkesën ndër të tjera theksohet se; Kontrata e blerjes e vitit 1990 e lidhur në mes të palës ankuese dhe shitësit ndërmarrjes shoqërore R. S., sipas së cilës paraqitësi i kërkesë pretendon se ka përfituar pronën e kërkuar, mandej faturat dhe dëshmitë se e ka paguar çmimin e plotë si dhe dëftesat e ndryshme të pagesave të viteve 1994-97, asnjëri nga këto dokumente nga sekretaria e AKP-së nuk është arrit të verifikohen si të vërtetë .I ftuar nga sekretaria paraqitësi i kërkesës ka dështuar për të ofruar dëshmi tjera valide në mbështetje të drejtës së tij pronësore. Po ashtu sekretaria ekzekutive nuk ka mundur *ex officio*, të siguroj ndonjë dëshmi që do të mbështeste kërkesën e paraqitur, në bazë të cilave do të verifikohesh se bartësi i të drejtë pronësore gëzon një të drejtë ligjore në pronën e kërkuar.

8. Vendimi i është dorëzuar palës ankuese S. N. me datë 03.02.2016, kundër tij ankesë ka parashtruar me datë 29.02. 2016.

Pretendimet e palës ankuese:

9. Pala ankuese Vendimin e ankimuar e konteston në tërësi për shkak të; cënimit thelbësor të dispozitave procedurale, vërtetimit jo të plotë dhe të saktë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të drejtës materiale.
10. Tutje thekson se lokali është pronë e tij, se për të njëjtin në AKP i ka dërguar dokumentet në fotokopije sepse nuk ka mundur ti gjej dhe dërgoj origjinalet andaj tani i dërgon fotokopijet e vëretuara në MZ Kralevë. Ankesës i bashkëngjet të gjitha dokumentet e paraqitura edhe më parë në AKP, të cilat genden në lëndë, të cekuara si në paragrafin 2 të këtij aktgjykimi.

Pranueshmëria e ankesës

11. Ankesa e palës ankuese është e pranueshme dhe e afatshme, e paraqitur brenda afatit prej 30 ditë ,ashtu si parashihet në nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin, nr. 03/L-79.

Meritat e Ankesës;

Arsyetimi ligjor

12. Gjykata Supreme pas shqyrtimit të vendimit të ankimuar sipas pretendimeve në ankesë dhe sipas detyrës zyrtare, si dhe shkresave të tjera të lëndës si në kuptim të nenit 194, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjen se ankesa është e pa bazuar.
13. Sipas nenit 3.1, të Ligjit nr.03/L-07, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhëresë nga komisioni për ri-posedim të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon jo vetëm të drejtën e pronësisë mbi një pronë të pa luajtshme private të kërkuar, por edhe që ai nuk është në gjendje aktualisht ti ushtroj ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë , ndërmjet 27 Shkurt 1998 dhe 20 Qershor 1999.
14. Sipas kësaj dispozite ligjore, pala ankuese në mbështetje të kërkesës së tij për të vërtetuar të drejtën e tij të pronësisë në pronën e kërkuar, duhet të paraqes prova dhe të ofroj fakte se e ka pas në posedim dhe shfrytëzim të ligjshëm në periudhën kohore të viteve 1998/99, dhe ta ketë humbur të drejtën e posedimit si rezultat i rrethanave në Kosovë, për të qen kompetent AKP për të shqyrtuar dhe vendosur në mënyrë meritore kërkesën e tij.
15. KKKPK-ja si në vendimin e saj ka vërtetuar se, asnjëri nga dokumentet e paraqitura nga pala ankuese nuk kanë mundur të verifikohen pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive, që do të

thotë se janë vërtetuar negativisht. Kërkesa rezultoi se nuk ishte mbështetur me ndonjë provë valide të ligjshme për të dëshmuar titullin e pronësisë në pronën e kërkuar, andaj pretendimet e tij nuk mund të çonin në pranimin e kërkesës nga KKPK.

16. Për sa i takon bazave ankimore të palës ankuese në ankesë, Gjykata Supreme duhet të përgjigjet në pyetjen nëse pala ankuese gjatë konfliktit të armatosur ka pasur ndonjë të drejtë pronësie apo ndonjë të drejtë të tjetër të shfrytëzimit mbi lokalin afarist të kërkuar.
17. Pala ankuese në ankesë i përsërit pretendimet e njëjta si edhe në kërkesë të deklaruara para KKPK-së, se e drejta e tij pronësore në lokalin afarist të kërkuar bazohet në kontratën mbi shitblerjen e lokalit, me të cilën ai pretendon se e ka blerë nga ndërmarrja e re shoqërore ndërtimore, "R. S." në vitin 1990, por është fakt se ky dokument bazik referent, mbi të cilin bazohet kërkesa e palës ankuese, (të cilin tani me ankesë e ofron të vërtetuar se është identik me origjinalin), e po ashtu edhe dokumentet përcjellëse të saj si, vërtetimi mbi kryerjen e pagesës së tërësishme të çmimit blerës të lokalit dhe faturat e ndryshme për komunalit e paguara të paraqitura nga pala ankuese të viteve 1994-97, asnjëri nga këto dokumente nuk kishte mundur të verifikohet nga ana e Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së, si ekzistues.
18. Kontrata e shitblerjes së paluajtshmërisë lëndore e paraqitur nga pala ankuese edhe tani me ankesë, nuk paraqet provë të vlefshme për të vërtetuar të drejtën e pronësisë mbi lokalin afarist, sepse nuk dëshmohet vërtetimi i nënshkrimeve të palëve kontraktuese në kontratë, nga gjykata kompetente, për tu konfirmuar vlefshmëria e kontratës. Kjo kontratë si e tillë nuk prodhon efekte ligjore detyruese, dhe juridikisht nuk e dëshmon vërtetësinë e saj. Për më tepër e njëjta kontratë nuk është gjetur as në Ndërmarrjen e re Shoqërore Ndërtimore, "R.S.", me seli në
19. Pala ankuese në fazën ankimore nuk ka paraqitur prova të reja apo dokumentacion tjetër valid nga ai që kishte paraqitur në AKP, i cili ishte verifikuar negativisht gjatë vendosjes në shkallën e parë dhe po ashtu *ex officio* nga sekretaria e AKP të cekur si në si në paragrafët 4-6, të këtij aktgjykimi, ishte vërtetuar se paluajtshmëria në të cilën pretendon se e ka qen dhe e ka blerë pronën e kërkuar ngastra kad.,nr..., evidentohet si pasuri shoqërore me kulturë objekt shkollor dhe kullosë, ndërsa nuk figuronte i regjistruar objekti-lokali të cilin e pretendon pala ankuese. Prandaj pretendimet e palës ankuese nuk janë të qëndrueshme apo të bazuara në prova dhe ligj për të vendosur ndryshe në këtë çështje, andaj refuzohen si jo të bazuara.
20. Nga faktet e cekura si më lartë Gjykata Supreme konstaton se vendimi i apeluar i KKPK-së është i drejtë dhe ligjor dhe nuk është i përfshirë me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike apo zbatim të gabuar të dispozitave të procedurës apo të drejtës materiale, siç theksohet nga pala ankuese në pretendimet e tij, andaj kërkesa e tij me të drejtë dhe bazë ligjore është refuzuar si jo e bazuar, në kuptim të nenit 11.4 b) dhe nenit 3 par. 3.1 të Rreg. së UNMIK 2006/50, e ndryshuar me Ligin 03/L-079.

21. Gjykata gjatë shqyrtimit të kësaj lënde edhe *ex officio* gjen se, Vendimi individual në gjuhë serbe, që i referohej kërkesës së palës ankuese me numër KPA49511, KPCC/D/C/232/2014, dt. 13.03.2014, ishte i përfshirë me gabim gjuhësor por që ky gabim nuk ndikon në përmbajtjen e qështjes së vendosur. Në vendimin individual në gjuhën serbe thuhet se, “*kërkesa hedhet*”, kurse në vendimin grupor në të trija gjuhët zyrtare në përdorim dhe në vendimin individual në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze thuhet se, “*kërkesa refuzohet*”.
22. Sipas dispozitave material përcaktohet se, në rast mospajtimi apo ndryshimi në mes të versionit në gjuhë angleze dhe versionit në gjuhët e tjera, versioni në gjuhë angleze mbizotëron, bazuar në nenin 3.3, të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5, për implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronat bujqësore dhe ato komerciale, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ku parashihet se, “*Kurdo që paraqitet ndonjë dallim apo papajtueshmëri në lidhje me ndonjë fjalë, frazë apo interpretim ndërmjet verzionit në gjuhën angleze të dokumentit apo vendimit karsbi verzionit në gjuhën shqipe apo serbe, fjala, fraza apo interpretimi në gjuhën angleze do të mbizotërojë dhe do të përdoret*”.
23. Prandaj me që vendimi burimor grupor në të trija gjuhët, dhe ai individual në gjuhë burimore angleze dhe gjuhë shqipe, figuron se “refuzohet kërkesa”, nuk është me ndikim gabimi gjuhësor në vendimin individual në gjuhë serbe, sepse duhet të jetë kërkesa refuzohet, e jo kërkesa hedhet, sepse interpretimi dhe verzioni në gjuhë angleze mbizotëron si origjiner dhe si i tillë përdoret.
24. Nga arsyet e paraqitura dhe në kuptim të nenit 13.3,(c), të Rreg. së UNMIK-ut, nr.2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike:

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

GSK-KPA-A-046-2016, me datë 09 Tetor 2019

**Bashkp. Profesional,
Sherif Krasniqi**

**Kryetari i Kolegjit,
Beshir Islami**